



---

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA GRAMSH

### RELACION TEKNIK

**Objekti: Sistemim – Asfaltim i bllokut të banimit te “Ish – SMT, lagja Sporti 2, bashkia Gramsh”**

#### Të përgjithshme

Ky objekt përfshin asfaltimin e rrugëve të brendshme të zonës së “Ish – SMT ” . Së bashku me asfaltimin e rrugëve të brendshme, do të realizohet edhe punimet e trotuareve, dhe sistemimi i ujrale të bardha në kanalizimet përkatëse të cilat do të sistemohen nëpërmjet kunetave prej betoni dhe pjerrësisë së rrugës që ujrat të shkojnë në pustetat e përcaktuara në projekt, si dhe punime për vendparkimin e makinave. Gjatësia e rrugës së asfaltuar të parashikuar në projekt është 1380 m dhe sipërfaqja e trotuareve është parashikuar 120 m.

#### Gjendja aktuale

Aktualisht, kjo zonë ndodhet në kushte të vështira përsa i përket infrastrukturës se rrugës, në mungesë të plotë të trotuarëve, si dhe ujrat sipërfaqësore janë të pa sistemuara. Për këto arsy, këta banorë kanë kërkuar sistemimin dhe asfaltimin e kësaj lagjeje.

#### Vizioni

Bashkia Gramsh ka hartuar projektin dhe kërkon ta implementojë atë duke synuar shndërrimin e kësaj zone të paurbanizuar në një mjedis të përshtashëm urban, të pajisur me gjithë infrastrukturën e duhur sa më afér nevojave të komunitetit, duke shmangur shmangur fenomenet e padëshirueshme si psh përblytjet.

#### Përshkrimi i punimeve

Në këtë projekt janë përfshirë punimet e ndërtimit të rrugëve, trotuarëve, kanalizime të ujrale të bardha, parkime dhe lulishte.

1. Punime prishje parashikon prishje shtresave të betonit breza shkalle, si dhe shkulje bordurash betoni ekzistuese dhe transportimin e tyre në vendin e përcaktuar për mbetjet inerte.
2. Punime në rrugë që përfshin gërmimin e trasesë së rrugës, punime të shtresave të domosdoshme si zhavorr, cakull, stabilizant, bitum.

3. Punime për kanalizimet e ujrale të bardha në të cilat përfshihen betonimet përkunetat.
4. Punime për vendparkimimin e automjeteve në të cilën përfshihen punimet e gërmimeve në seksion dhë të lirë dhe për themele, F.V të borduravë të betonit, betonim të themeleve të tyre, punime shtresash e struktura të betonit.
5. Punime trotuari të cilat konsistojnë në gërmimin e dheut të lirë dhe për themele, F.V bordurave të betonit, si dhe trotuari me pllaka betoni.
6. Punime të gjelbërimit të cilat konsistojnë në mbushje me dhë të pasuar, sistemime, mbjellje me bar dekorativ, peme dhe shkurre dekoruese, stola dhe minikosha.

HARTOI

Ing. Eva ISMAILAJ

